



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 413/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkritazi lidhur me ankesën e Ertan Simitçi, nga Prizreni, paraqitur kundër Fikrim Damka, kandidat për deputet nga subjekti politik KDTP, për shkak të presionit tek votuesit, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pasafatshme ankesa Anr.413/2017 e datës 30.06.2017, parashtuara nga Ertan Simitçi, nga Prizreni.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 30.06.2017, nga Ertan Simitçi, nga Prizreni, me të cilën pretendon se në ditën e zgjedhjeve në qendrën e votimit në shkollën teknike “11 Marsi”, kandidati për deputet Fikrim Damka, nga radhët e subjektit politik KDTP ka zhvilluar takime me qytetarët për të votuar dhe duke mos lejuar për të votuar për kandidatët e tjerë dhe se i njëjti ka zhvilluar takime edhe në lagjen “Korilla” afër shkollës “Motrat Qiriazhi”. Parashtruesi ankesës si provë i ka bashkangjitur 5 fotografi të printuara, duke kërkuar nga PZAP-i, që të filloj hetimet për këto raste.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesës, gjeti se :

Ankesa është e pasafatshme

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 119 par. 1, të LZP-së. Në rastin konkret qendra e votimit është mbyllur më datë 11.06.2017, në ora 19:00, ndërsa ankesa nga ankuesi është parashtuar në PZAP me datë 30.06.2017, që do të thotë pas afatit të paraparë me ligj të përcaktuar me nenin 119 par. 1 të LZP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lart ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par. 4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 413/2017 më datën 02.07.2017



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.